

Me rastin e Asamblesë së pestë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prishtinë më 10 korrik 2008,

Asambleja e përbërë nga këta gjyqtarë: Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Guy Van Craen, Olavi Snellman, Andrea Cruciani, Angela Kaptein; Michael Zimmermann, Norbert Koster, Christine Lindemann-Proetel, Michael Simmons, Gerrit-Marc Sprenger; Gianfranco Gallo; Emilio Gatti.

Njëzëri miraton VENDIMIN

Të aprovohen Udhëzimet për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndët civile.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Udhëzime për përzgjedhjen e lëndëve dhe alokimin e lëndëve për gjykatësit e EULEX-it në lëndë civile

Prapavija ligjore

Alokimi i lëndëve për gjykatësit e EULEX-it do të zbatohet në pajtim me Ligjin mbi Jurisdikcionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe alokimin e lëndëve për gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053) (Ligji mbi Jurisdikcionin).

Këto udhëzime shërbejnë për të shtjelluar përskrimet mbi alokimin e lëndëve ofruar sipas ligjit të lartpërmendur.

Parimet

- **Transparenca**

Alokimi i lëndëve duhet të jetë transparent për akterët dhe jo-akterët në sistemin e drejtësisë.

- **Paanshmëria**

Secili duhet ta dijë paraprakisht se ku dhe te cili gjykatës ai/ajo do të gjykohet.

- **Fleksibiliteti**

Kushtet specifike të punës dhe numri i gjykatësve të EULEX-it duhet të merret parasysh.

- **Qëndrueshmëria**

Sistemi për alokimin e lëndëve duhet të jetë shembull i një administrimi të mirë të drejtësisë, të cilin gjykatësit vendorë mund (duhet) ta ndjekin në mënyrë që të përmbushen qëllimet për një administrim të pavarur, transparent dhe efikas të drejtësisë.

- **Barazia e ngarkesës së punës për gjykatësit**

Përzgjedhja e lëndëve dhe sistemi i alokimit

1. Neni 5.1 a): çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

1.1.: Në pajtim me nenin 5.1 a) të Ligjit mbi Jurisdikcionin, gjykatësit e EULEX-it do ta kenë autoritetin të përzgjedhin dhe të marrin përgjegjësinë mbi lëndët që janë në jurisdikcion të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, përfshirë këtu edhe rastet që iu janë dërguar ndonjë gjykate tjetër në pajtim me ligjin. Jurisdikcioni i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit është i qeverisur nga Ligji mbi Jurisdikcionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Alokimin e Lëndëve për gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë dhe nga ligji tjetër i aplikueshëm, aktualisht Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13, e korrigjuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe asaj 2008/19.

1.2.: Kur gjykatësit e EULEX-it janë të vendosur në panelet e Dhomës së Posaçme, lëndët do të alokohen në pajtim me rregullat e brendshme të Dhomës së Posaçme, bazuar në kriteret objektive të paracaktuara dhe kujdesin procedural. Rregullat e tilla të brendshme do të përpilohen veçmas, duke marrë parasysh strukturën specifike të Dhomës së Posaçme.

2. Neni 5.1 b): Paneli për ankesa / Komisioni Kosovar i Padive për Pronat

2.1.: Në pajtim me nenin 5.1 b) të Ligjit mbi Jurisdikcionin, gjykatësit e EULEX-it do ta kenë autoritetin të përzgjedhin dhe të mbajnë përgjegjësinë mbi lëndët që janë jurisdikcion i secilës gjykatë të Kosovës lidhur me ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar të Padive për Pronat sipas ligjit të aplikueshëm. Jurisdikcioni i panelit për ankesa brenda Gjykatës Supreme është i qeverisur nga Ligji mbi Jurisdikcionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Alokimin e Lëndëve për Gjykatësit dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë dhe ligjit tjetër të aplikueshëm Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10, ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50.

2.2.: Kur gjykatësit e EULEX-it janë të vendosur në panelin që ka jurisdikcion në ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar të Padive për Pronat, nuk ekziston nevoja për qartësime më të hollësishme në përgjedhjen e lëndëve. Lëndët do të alokohen sipas rregullave të brendshme të Dhomës së Posaçme, bazuar në kriteret objektive të paracaktuara dhe kujdesin procedural. Rregullat e tilla të brendshme do të përpilohen veçmas, duke pasur parasysh strukturën specifike të panelit për ankesa.

3. Neni 5.1 c): Gjykatat e Qarkut

3.1.: Në pajtim me nenin 5.1 c) të Ligjit mbi Jurisdikcionin, gjykatësit e EULEX-it do të kenë autoritetin për të përzgjedhur dhe përgjegjësinë mbi lëndët e reja dhe atyre të pazgjidhura pronësore, përfshirë edhe procedurat ekzekutive brenda

jurisdikcionit të secilës gjykatë në Kosovë poqese kërkesat e përmendura në nenin 5.1 c) (i), (ii) dhe (iii) përmbushen.

- 3.2.: Secila Gjykatë e Qarkut do të ketë dy gjykatës civil të EULEX-it. Me rradhë këta do të përzgjedhin lëndët në Gjykatat e Qarkut. Secila rradhë do të zgjasë një muaj.
- 3.3.: Gjykatësi përzgjedhës do të jetë personi i parë kontaktues për Kryetarin e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it. Gjykatësi përzgjedhës do të raportojë Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mbi lëndët e zgjedhura dhe çështje të tjera relevante çdo javë.

Lëndët e reja

- 3.4.: Definicioni i lëndës së re: lënda është e re kur futet në dosje dhe regjistrohet në gjykatë, por nuk shpërmdahet nga Kryetari i Gjykatës gjykatësit vendor.
- 3.5.: Për akomodimin e përzgjedhjes së lëndës së re, Kryesekretari i secilës Gjykatë të Qarkut do të njoftojë gjykatësin përzgjedhës të EULEX-it mbi çdo lëndë të re pronësore duke i dërguar menjëherë dosjen gjykatësit të EULEX-it, i cili në atë muaj është përgjegjës për të përzgjedhur.
- 3.6.: Nëse përzgjedhet një lëndë e re, gjykatësi përzgjedhës i EULEX-it do ta informojë Kryetarin e Gjykatës kompetente të Qarkut dhe Kryetarin e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mbi vendimin e tij apo të saj.

Lëndët e pazgjidhura

- 3.7.: Definicioni i lëndës së pazgjidhur: lënda është e pazgjidhur në rast se është futur në dosje dhe regjistruar në Gjykatën Komunale apo në atë të Qarkut dhe iu është alokuar gjykatësit vendor.
- 3.8.: Në pajtim me nenin 5.1 c) Gjykatësit e EULEX-it, të caktuar nëpër gjykata të Qarkut do ta kenë autoritetin të përzgjedhin dhe të marrin përgjegjësinë mbi lëndët që kanë të bëjnë me pronën dhe që janë akoma të pazgjidhura nëpër gjykatat komunale.
- 3.9.: Lista në vijim (nga a gjer i) përmban shembuj të lëndëve të pazgjidhura që kanë të bëjnë me pronën dhe që hyjnë brenda nenit 5.1 c) dhe mund, por nuk është e patjetërsueshme të përzgjedhen nga gjykatësit e EULEX-it.
 - a) Lëndët për kompenzim kundër UNMIK-ut, KFOR-it, komunave dhe personave privatë si pasojë e ngjarjeve të viteve 1999 dhe 2004 dhe që janë pezulluar nga UNMIK-u;
 - b) Lëndët e dërguara në gjykatat kompetente vendore nga Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore (KKBP);

- c) Lëndët e dërguara në gjykatat kompetente vendore nga Komisioni Kosovar për Kërkesa Pronësore (KKKP);
 - d) Lëndët për pronat e patundshme private, përfshirë këtu edhe ato bujqësore dhe komerciale, të dorëzuara në gjykatat vendore para themelimit të Agjencisë Kosovare të Pronës, sipas nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50;
 - e) Lëndët për pronën e patundshme private, përfshirë këtu edhe ato bujqësore dhe komerciale, të cilat bien brenda jurisdiksionit të Agjencisë Kosovare për Pronën, dhe që janë dorëzuar padashje në gjykatat vendore;
 - f) Lëndët për pronat e patundshme private, përfshirë këtu edhe ato bujqësore dhe komerciale që hyjnë brenda mandatit të Agjencisë Kosovare për Pronën, dhe që janë dorëzuar në gjykatat vendore pas skadimit të afatit për dorëzimin e padisë (3 dhjetor 2007), e aplikueshme për Agjencinë Kosovare për Pronën;
 - g) Lëndët që iu janë deleguar gjykatave vendore nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, sipas nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4;
 - h) Lëndët e ekzekutimit civil që u përkasin lëndëve që hyjnë në një ndër kategoritë e lartpërmendura;
 - i) Lëndë të tjera të ngjashme pronësore civile.
- 3.10.:** Për përzgjedhjen e lëndës, do të mjaftojë që një ndër kërkesat, të përmendura në nenin 5.1 c) (i), (ii) dhe (iii) të përmbushen. Dyshime të bazuara do të mjaftojnë për përmbushjen e një ndër kërkesave.
- 3.11.:** Përmbushja e kërkesave të përmendura në nenin 5.1 c) (i), (ii) dhe (iii), që rezultojnë në përzgjedhjen e lëndës mund të bëhet pa bindjen paraprake të gjykatësit dhe apo pa kërkesën e palës bazuar në nenin 71 të Kodit Civil Procedural apo ndonjë kërkesë tjetër.
- 3.12.:** Nëse përzgjidhet lënda e pazgjidhur, gjykatësi i përzgjedhur i EULEX-it do të informojë Kryetarin e Gjykatës kompetente të Qarkut dhe Kryetarin e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mbi vendimin e tij apo të saj. Ky vendim duhet të jetë i bazuar, duke marrë parasysh kërkesat e cekura në nenin 5.1 c) (i), (ii) dhe (iii).
- 3.13.:** Në pajtim me nenin 5.7 të Ligjit mbi Jurisdiksionin, gjykatësi vendor i caktuar në lëndën përkatëse, kryestari i gjykatës kompetente dhe palët përkatëse do ta kenë të drejtën të dëgjohen nga ana e Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it.
- 3.14.:** Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mund të delegojë përgjegjësinë e tij apo të saj gjykatësit civil apo penal të EULEX-it, siç është cekur në paragrafin 3.12. dgdfg.

- 3.15.:** Në mënyrë që Kryetari i Gjykatës kompetente të Qarkut, gjykatësi vendor dhe palët të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre në pajtim me nenin 5.7 të Ligjit mbi Jurisdikcionin, një dëgjim do të bëhet çdo të dytin muaj në secilën gjykatë të qarkut.
- 3.16.:** Pas dëgjimit, Kryetari i Asamblesë së EULEX-it apo gjykatësi i emëruar i EULEX-it do të sjellë një vendim të duhur mbi kundërshtimin e palës apo palëve. Apelimi kundër këtij vendimi nuk është i mundur.

4. Përbërja e paneleve dhe alokimi

- 4.1.:** Në pajtim me nenet 5.2 dhe 5.3 të Ligjit mbi Jurisdikcionin, paneli gjithnjë do të përbëhet nga tre gjykatës, dy nga të cilët do të jenë gjykatës të EULEX-it poqese nuk merret vendim tjetër nga Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it (në pajtim me nenin 5.5 të Ligjit mbi Jurisdikcionin).
- 4.2.:** Lëndët e zgjedhura do t'u alokohen gjykatësve sipas sistemit numerik, me ç'rast çdo e treta lëndë do t'i alokohet gjykatësit A, çdo e treta lëndë gjykatësit B dhe çdo e treta lëndë gjykatësit C (numri 1 gjykatësit A, numri 2 gjykatësit B, numri 3 gjykatësit C, numri 4 gjykatësit A dhe kështu me rradhë). Për arsye të jashtëzakonshme, siç mund të jetë ngarkesa e lëndëve, gjykatësi përzgjedhës mund të alokojë lëndët në një mënyrë tjetër nga ajo e lartpërmendur.
- 4.3.:** Gjykatësi të cilit iu është alokuar lënda është përgjegjës për përgatitjen e lëndës si dhe për marrjen e gjykimit dhe vendimeve të tjera që ndërlidhen me lëndën.
- 4.4.:** Vendimi kornizë i Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it do të veçojë automatizmat e zëvendësimeve siç vijon:
- Gjykatësit në GJQ në **Pejë/Peć** do të caktohen në GJQ në **Prizren/Prizren** dhe **anasjelltas**.
 - Gjykatësit në GJQ në **Prishtinë/Priština** do të caktohen në GJQ në **Gjilan/Gnjilane** dhe GJQ në **Mitrovicë/Mitrovica** dhe **anasjelltas**.
- 4.4.:** Sistemi i kujdestarisë do të krijohet për situata emergjente për gjykatat e përmendura më sipër në mënyrë që të ketë gjykatës në dispozicion edhe në sitata emergjente.
- 4.5.:** Në rast të ndonjë sëmundje apo situatë tjetër të papritur, zëvendësuesi do të caktohet nga sektori tjetër i gjykatës përkatëse apo nëse është e nevojshme, do të aplikohet sistemi i përshkruar në nenin 4.4.

5. Të tjera

- 5.1.:** Elementi monitorues i gjykatësve të EULEX-it zbatohet sipas udhëzimeve të veçanta të themeluara nga Asambleja e Gjykatësve të EULEX-it.